

Projekti “Forcimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për zbatimin e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar në Shqipëri” zbatohet nga World Vision Shqipëri (WV) si organizata drejtuese në këtë projekt në bashkëpunim me “Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” (ADRF) dhe me organizatën “Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të kufizuara” (MEDPAK), me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian (BE).



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian



Platforma on-line (www.platforma-pak.al) “Aftësia e kufizuar dhe barazia”

Në kuadër të projektit “Forcimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për zbatimin e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar në Shqipëri” që po zbatohet nga World Vision Shqipëri (WV), në bashkëpunim me “Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” (ADRF) dhe me organizatën “Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të kufizuara” (MEDPAK), me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian (BE), është ndërtuar një platformë on-line (www.platforma-pak.al) e cila ka për qëllim rritjen e njohurive dhe të kapaciteteve të stafeve të institucioneve, organizatave të shoqërisë civile, personave me aftësi të kufizuara, si dhe shoqërisë në tërësi mbi çështje të aftësisë së kufizuar dhe barazisë.

FSHDKPAK kontakte:

Adresa: Rr. “Bogdani”, pall. 15 kat i III Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 269 426

Email: adrf@albmail.com

www.adrf.al

Kontakte Platforma
www.platforma-pak.al

• Qëllimi i Platformës

Platforma synon që përmes rritjes së njohurive dhe kapaciteteve, duke u fokusuar edhe në detyrimet që parashikojnë ligjet, politikat, rregullat e etikës, të nxisë:

- (i) komunikimin efektiv mes institucioneve dhe personave me aftësi të kufizuara;
- (ii) të nxisë institucionet dhe personat që të përmirësojnë praktikatat e tyre;
- (iii) të nxisë institucionet që të marrin masat e nevojshme për sigurimin e aksesueshmërisë përmes zbatimit të legjisllacionit.

• Çfarë përmban platforma?

Platforma online është e organizuar në formën e një moduli trajnimi (E-Trajnim) dhe ofron informacion përfshirës për çdo palë të interesuar në fushën e aftësisë të kufizuar.

Pjesë e kësaj platforme është edhe një bibliotekë online e cila shërben si qendër burimore për legjisllacionin dhe politikat mbi personat me aftësi të kufizuara.

Platforma është e aksesueshme lehtësisht nga të gjithë dhe përmban të gjitha elementet e aksesueshmërisë për personat që kanë aftësi të kufizuara të ndryshme. Platforma është konceptuar si një hapësirë interaktive ku çdo person i interesuar rreth çështjeve të aftësisë të kufizuar mund të drejtohet me pyetje në hapësirën “Pyetje të shpeshta”.

• Si është e organizuar platforma?

I. E- TRAJNIM

E-trajnimi mund të përdoret nga stafet e institucioneve, organizatat, personat me aftësi të kufizuara apo edhe persona të tjerë juridike dhe fizikë, përfshirë subjektet privatë në mënyrë të pavarur. E-trajnimi është konceptuar si një trajnim ndërveprues, i shoqëruar me shembuj konkretë, ushtrime, video dhe foto. Personat mund ta kryejnë trajnimin individualisht.

Në këtë hapësirë do të gjeni informacion mbi:

- i) të dhëna rreth personave me aftësi të kufizuar;
- ii) terminologjinë, barierrat, modelet e aftësisë së kufizuar dhe fjalorth;
- iii) rregullat e etikës;
- iv) legjisllacionin që rregullon çështjet e barazisë;
- v) legjisllacionin që rregullon çështjet e aksesueshmërisë.

II. E- BIBLOTEKË

Biblioteka përmban:

- i) legjisllacionin bazë që mbulon fushat e aksesueshmërisë, arsimit, punësimit profesional, pjesëmarrjes në jetën politike dhe publike, shërbimet shoqërore dhe shëndetësore;
- ii) dokumente politike në fushën e aftësisë së kufizuar;
- iii) informacione dhe botime të prodhuara në kuadër të këtij projekti.

Për më shumë informacion mbi përdorimin e kësaj platforme, ju ftojmë të ndiqni videon sqaruese në këtë adresë www.platforma-pak.al